



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 643 prot.

Roskovec, më 01.08.2024

VENDIM

Nr. 47, datë 31.07.2024

PËR

**MIRATIMIN NË PARIM DHE AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË PËR  
LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT ME DREJTORINË E  
PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT "PËR NDËRTIMIN E POSTËS SË  
POLICISË ROSKOVEC"**

Në mbështetje të neneve 3, 8, 9, pika 1.2 dhe pika 1.6 dhe 54 shkronja "e/1" dhe "k" të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr.108/2014 "Për policinë e shtetit" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 459, datë 26.7.2018 "Për kalimin në pronësi të Bashkisë Roskovec, të pronës me emërtimin "Posta e Policisë Roskovec" dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik", të ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 455, datë 10.7.2024 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut nr. 3, në qendër të qytetit të Roskovecit (Faza 1)", Bashkia Roskovec"; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec me nr. 64, datë 17.08.2018 "Për kryerjen e procedurave të shpronësimit për projektin "Rehabilitim i bllokut Urban nr.2 Roskovec"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35 datë 13.06.2016 "Për miratimin e projektit të investimit me objekt "Rehabilitimi urban i tre blloqeve në Bashkinë Roskovec"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.68 datë 26.09.2017 "Për miratimin e projektit me objekt "Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr.2 Qendra e qytetit Roskovec"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 91, datë 31.10.2023 "Për miratimin e projektit "Rehabilitimi urban i një pjese të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec (Faza 1)"; Marrëveshjes së bashkëpunimit

datë 20.07.2017 ndërmjet Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Bashkisë Roskovec “Për dakordësinë institucionale midis dy institucioneve, DVP Fier dhe Bashkisë Roskovec “Mbi përcaktimin e objektit që do të shërbejë për sistemimin e SP Roskovec, deri në përfundimin e investimit”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

1. Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për bashkëfinancimin e zbatimit të projektit me objekt: "Ndërtimi i Postës së Policisë Roskovec", pjesë e projektit të Rehabilitimit urban të bllokut nr. 3 në qendër të qytetit Roskovec.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Pjesë përbërëse e Vendimit është Marrëveshja e Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
4. Ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë dhe Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**

